FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.185 dhjetor 2010

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr.6832 datë 28.12.2010	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	10283
Dekret nr.6833 datë 28.12.2010	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	10283
Vendim i KM nr.1060, datë 31.12.2010	Për një ndryshim në vendimin nr.988, datë 1.12.2010 të Këshillit të Ministrave "Për ruajtjen dhe sigurimin e objekteve të Bankës së Shqipërisë".....	10284
Vendim i KM nr.1061, datë 8.7.2010	Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të Policisë së Burgjeve.....	10284
Vendim i KM nr.1063, datë 15.12.2010	Për miratimin e kuotës së pranimit e të tarifës së shkollimit, në programet e studimeve të doktoratës, në Universitetin e Tiranës, Universitetin Politeknik të Tiranës, Universitetin Bujqësor të Tiranës, Qendrën e Studimeve Albanologjike, universitetin "Aleksandër Moisiu" të Durrësit, universitetin "Ismail Qemali" të Vlorës dhe Akademinë e Mbrojtjes "Spiro Moisiu", në vitin akademik 2010-2011.....	10285
Vendim i KM nr.1064, datë 22.12.2010	Për disa ndryshime në vendimin nr.391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave".....	10289
Vendim i KM nr.1065, datë 29.12.2010	Për kriteret dhe procedurat e kryerjes së rimbursimit nga taksa e biznesit të vogël të pagesës për pajisjet fiskale dhe taksimetrat	10293

Vendim i KM nr.1066, datë 29.12.2010	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga rikonstruksioni i rrugës “Gjokaj”, në bashkinë e Vorës të qarkut të Tiranës.....	10295
Vendim i KM nr.1067, datë 29.12.2010	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga sistemim-asfaltimi i bllokut lindor, lagjja e Stanit në bashkinë e Divjakës	10296
Vendim i KM nr.1068, datë 29.12.2010	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të IEVP burgu nr.325, burgu Vaqar, burgu nr.302, spitali i burgut Tiranë, IEVP Shënkoll, Lezhë, IEVP Bënçë, Tepelenë, IEVP Rrogozhinë, IEVP Lushnjë (fshati Kosovë, komuna Fierzë, Elbasan) dhe të godinës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Drejtësisë, për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.....	10297
Vendim i KM nr.1069, datë 29.12.2010	Për miratimin e dëmshpërblimit financiar për ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist.....	10297
Vendim i KM nr.1071, datë 29.12.2010	Për disa ndryshime në vendimin nr.826, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë dhe tarifat e shkollimit për studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, në vitin akademik 2010-2011”, të ndryshuar	10315
	Vendim (i shkurtuar) për shpalljen të zhdukur të shtetasit Arjan Damazeti.....	10319

DEKRET
Nr.6832, datë 28.12.2010

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" të Kushtetutës, të nenit 9 dhe të nenit 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Ada Valentin Gajtani
2. André Yves Julien Marcel Marcel Jean Eugēne Müler
3. Angjelin Valentin Gajtani
4. Ashgan Hassan Mohamed Mohamed
5. Besart Avdulla Avdullahu
6. Besfort Avdulla Avdullahu
7. Bünyamin Ali Ihsan Diricanli
8. Camilla Francesco Maenza
9. Fadi Samir Rihan
10. Jakup Rexhep Ferri
11. Merita Niazi Gajtani (Tuçi)
12. Naime Mehmet Ferri (Shala)
13. Rashad Mohamed Moursi Badr
14. Sedat Musa Zeki
15. Seif Rashad Mohamed Moursi Badr
16. Shpresa Isa Musa
17. Toska Rexhep Ferri
18. Tringa Rexhep Ferri
19. Űmit Cevdet Gülçimen
20. Valentin Angjelin Gajtani
21. Youssef Rashad Mohamed Moursi Badr

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET
Nr.6833, datë 28.12.2010

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" të Kushtetutës, të neneve 19 dhe 24 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U rijepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre:

1. Arben Sali Bajrami
2. Dardan Shefqet Kelmendi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

VENDIM
Nr.1060, datë 31.12.2010

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.988, DATË 1.12.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR RUAJTJEN DHE SIGURIMIN E OBJEKTEVE TË BANKËS SË SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës "dh" të nenit 4 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 "Për Policinë e Shtetit" dhe të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.988, datë 1.12.2010 të Këshillit të Ministrave, dispozita e hyrjes në fuqi ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Ky vendim hyn në fuqi më 1 mars 2011.".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1061, datë 8.7.2010

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË BURGJEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, të ligjit nr.10 032, datë 11.12.2008 "Për Policinë e Burgjeve" dhe të ligjit nr. 10 190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Burgjeve janë sipas lidhjes nr.1, "Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Burgjeve", që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Paga bazë mujore për gradë (kolona 3) e lidhjes nr.1, është niveli i pagës së punonjësit, në përputhje me gradën që ka fituar.

3. Shtesa për natyrë të veçantë pune dhe shërbimi (kolonat 4, 5 e 6) të lidhjes nr.1, jepet sipas funksioneve të përcaktuara në këtë lidhje.

4. Punonjësi i Policisë së Burgjeve me grada, për kohën e qëndrimit në gradë, përfiton shtesë për vjetërsi në punë, në masën 1 për qind, pas çdo viti pune. Masa e shtesës për vjetërsi në punë të jetë deri në nivelin e pagës bazë të gradës pasardhëse.

Përllogaritja e shtesës për vjetërsi në punë të fillojë në çastin e marrjes së gradës së re, sipas ligjit nr.10 032, datë 11.12.2008 "Për Policinë e Burgjeve".

5. Vendimi nr.366, datë 14.6.2006 i Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të Policisë së Burgjeve", të ndryshuar, shfuqizohet.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2010, do të përballohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e vitit 2010, për Policinë e Burgjeve.

7. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

10284

LIDHJA NR.1
STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË BURGJEVE

Roli	Grada	Paga bazë për gradë	Shtesa për natyrë të veçantë pune e shërbimi		
			Në funksion të policisë së regjimeve të jashtme, në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale	Në funksion të policisë së regjimeve të brendshme dhe transferim-shoqërimet në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale	Në funksion të policisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve
1	2	3	4	5	6
Bazë	Nëninspektor	34000	4000	8000	
	Inspektor	38000	4000	8000	
	Kryeinspektor	43000	4000	8000	2000
I mesëm	Nënkomisar	52500	4000	8000	2000
	Komisar	57000	4000	8000	2000
	Kryekomisar	80000	4000	8000	2000
I lartë	Drejtues	92000			6500
	Drejtues i I-rë	95000			10000

VENDIM
Nr.1063, datë 15.12.2010

PËR MIRATIMIN E KUOTËS SË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT, NË PROGRAMET E STUDIMEVE TË DOKTORATËS, NË UNIVERSITETIN E TIRANËS, UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS, UNIVERSITETIN BUJQËSOR TË TIRANËS, QENDRËN E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE, UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU" TË DURRËSIT, UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI" TË VLORËS DHE AKADEMINË E MBROJTJES "SPIRO MOISIU", NË VITIN AKADEMIK 2010-2011

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kuotës së pranimit, gjithsej, 1266, në programet e studimeve të doktoratës, në Universitetin e Tiranës, Universitetin Politeknik të Tiranës, Universitetin Bujqësor të Tiranës, Qendrën e Studimeve Albanologjike, universitetin "Aleksandër Moisiu" të Durrësit, universitetin "Ismail Qemali" të Vlorës dhe Akademinë e Mbrojtjes "Spiro Moisiu", në vitin akademik 2010-2011.

2. Kuota e pranimit, e përmendur në pikën 1, e ndarë sipas institucioneve publike të arsimit të lartë dhe programeve të studimeve të doktoratës, paraqitet në tabelën nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Në kuotën e çdo programi studimi të doktoratës, 10% caktohet për kandidatët nga trojet shqiptare jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë.

4. Tarifa e shkollimit, për çdo program të studimeve të doktoratës në institucionet publike të arsimit të lartë civil, si dhe për doktorantët nga jashtë Forcave të Armatosura në programet e studimeve të doktoratës në Akademinë e Mbrojtjes "Spiro Moisiu", është 204 600 (dyqind e katër mijë e gjashtëqind) lekë, e cila paguhet në këste, të përcaktuara nga institucioni përkatës i arsimit të lartë.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i secilit institucion publik i arsimit të lartë, pa efekte buxhetore shtesë.

6. Rishpërndarja e kuotave të paplotësuara bëhet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

7. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Universiteti i Tiranës, Universiteti Politeknik i Tiranës, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Qendra e Studimeve Albanologjike, universiteti "Aleksandër Moisiu" i Durrësit, universiteti "Ismail Qemali" i Vlorës dhe Akademia e Mbrojtjes "Spiro Moisiu" për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha
10285

TABELA NR.1

KUOTAT E DOKTORATËS, 2010-2011

		UT	UPT	UBT	QSA	UD	UV	Akademia Mbrojtjes	Shuma
Nr.	**Emërtimet e programeve të studimit**	**2010-2011**	**2010-2011**	**2010-2011**	**2010-2011**	**2010-2011**	**2010-2011**	**2010-2011**	
1	Biologji e Ruajtjes	15							15
2	Biologji Molekulare	10							10
3	Fizikë	10							10
4	Bioteknologji Bimore	10							10
5	Elektrokimi e Zbatimit dhe Dukuritë Sipërfaqsore	10							10
6	Analiza Kimike e Lëndës dhe Mjedisit	10							10
7	Teknologji dhe Mikrobiologji Ushqimore dhe Vlerësimi i Sigurimit	10							10
8	Proceset e Trajtimit Kimik të Lëndës Para Natyrore	10							10
9	Analizë dhe Algjebër	10							10
10	Metodat Probab. Statis. e Met. e Analiz. Numerike	10							10
11	Sisteme të Avancuara të Informacionit	15							15
12	Shkenca Gjuhësore	25							25
13	Letërsi Botërore	10							10
14	Kërkime Gjuhësore	25							25
15	Studime Letrare	30			15				45
16	Histori	30							30
17	Gjeografi	30							30
18	Arkeologji	15							15
19	Trashëgimi Kulturore	15							15
20	Marrëdhënie Ndërkombëtare	25							25
21	Shkenca Komunikimi	10							10
22	Pedagogji	20							20
23	Psikologji	20							20
24	Filozofi	20							20
25	Punë Sociale	20							20
26	Sociologji	20							20
27	Shkencat Juridike Civile	30							30
28	Shkencat Penale	30							30
29	E Drejta Publike	30							30

30	Ekonomiks	33							33
31	Menaxhim	32							32
32	Marketing	23							23
33	Metodat Sasiore dhe të Informacionit	34							34
34	Financë	33							33
35	Kontabilitet	25							25
36	Kirurgji e Përgjithshme	6							6
37	Sëmundje e Brendshme	9							9
38	Mjeku i Familjes	3							3
39	Stomatologji	5							5
40	Anatomi Patologjike - Mjekësi Ligjore	4							4
41	Sëmundjet Infektive - Dermatologji	5							5
42	Obstetrike-Gjinekologji	3							3
43	ORL - Okulistikë	4							4
44	Imazheri	2							2
45	Lëndët Biomjekësore-Eksperimentale	2							2
46	Kardiologji	3							3
47	Neuroshkencë	9							9
48	Farmaci	4							4
49	Morfologji Kimike	4							4
50	Laborator	5							5
51	Pediatri	5							5
52	Shëndet Publik	2							2
53	Lëndët Klinike	40							40
54	Lëndë Paraklinike	40							40
55	Automatizim i Industrisë		2						2
56	Etektroteknikë		2						2
57	Elektroenergjitike		2						2
58	Teknologji e Informacionit dhe Komunikimit		8						8
59	Ndërtim		14						14
60	Arkitekturë dhe Urbanistikë		14						14
61	Gjeodezi		14						14

62	Gjeoshkencat, Burimet dhe Mjedisi		12						12
63	Inxhinieri Matematike		14						14
64	Inxhinieri Fizike		14						14
65	Bujqësia dhe Mjedisi, me drejtime:								0
66	i.Shkencat Agronomike			14					14
67	ii. Shkencat e Prodhimit Shtazor			8					8
68	iii. Shkencat e Hortikulturës			8					8
69	iiii. Shkencat Mjedisore			14					14
70	iiiii. Shkencat e Mbrojtjes së Bimëve			6					6
71	Ekonomi dhe Agrobiznes, me drejtimet:								0
72	i. Drejtim Agrobiznesi			10					10
73	ii. Ekonomi dhe Politike Agrare			10					10
74	iii. Financë-Kontabilitet			10					10
75	Shkencat dhe Bioteknotogjia Ushqimore			5					5
76	Shkencat Pyjore, me drejtimet:								0
77	i. Qeverisja e Qëndrueshme e Burimeve Pyjore			8					8
78	ii. Teknologjia e Drurit			**7**					**7**
79	Mjekësi Veterinare			30					30
80	Shkencat Gjuhësore				15				15
81	Shkencat Etnologjike dhe Folklor				15				15
82	Shkencat Historike				15				15
83	Shkencat Arkeologjike				10				10
84	Shkencat Ekonomike					30			30
85	Matematikë						30		30
86	Siguria							30	30
87	Mbrojtja							20	20
	Shuma	**860**	**96**	**130**	**70**	**30**	**30**	**50**	**1266**

VENDIM
Nr.1064, datë 22.12.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.391, DATË 21.6.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE NË SEKTORIN E PYJEVE DHE TË KULLOTAVE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5 të nenit 17 të ligjit nr.9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor", të ndryshuar, dhe të nenit 34 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr.391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Për shitjen e lëndës drusore në këmbë zbatohen tarifat bazë, sipas lidhjeve 1/a dhe 1/b, të shtojcës që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Tarifat e materialit drusor të asortuar, që shitet në anë të rrugës, përcaktohen sipas çmimeve të tregut, por jo nën çmimin e kostos së prodhimit, e cila përllogaritet mbi tarifat bazë të shitjes së lëndës drusore në këmbë.

Për shfrytëzimin e ngastrave pa rrugë autopyjore, në varësi të investimeve të kryera për 1 m^3 material drusor në këmbë, tarifa e lëndës drusore në këmbë, korrektohet, si më poshtë vijon:

a) Kur shpenzimet për ndërtimin e rrugës arrijnë deri në 200 lekë/m^3, tarifa bazë e lëndës drusore në këmbë, e fituar sipas vlerës së ankandit, korrektohet me koeficientin 0.8;

b) Kur shpenzimet për ndërtimin e rrugës arrijnë nga 201-300 lekë/m^3, tarifa bazë e lëndës drusore në këmbë, e fituar sipas vlerës së ankandit, korrektohet me koeficientin 0.7;

c) Kur shpenzimet për ndërtimin e rrugës arrijnë mbi 300 lekë/m^3, tarifa bazë e lëndës drusore në këmbë, e fituar sipas vlerës së ankandit, korrektohet me koeficientin 0.6.".

2. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2. Për përdorim sipërfaqesh të fondit pyjor e kullosor publik, zbatohen tarifat dysheme, që llogariten duke mbajtur parasysh përdorimin aktual të territorit dhe kohëzgjatjen e veprimtarisë së parashikuar, sipas lidhjes 2 të shtojcës, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.".

3. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"4. Për heqjen e miratuar të sipërfaqeve nga fondi pyjor dhe kullosor publik, zbatohen përllogaritjet sipas lidhjes 4 të shtojcës, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.".

II. Lidhjet 1/a, 1/b, 2 dhe 4, që i bashkëlidhen vendimit nr.391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave, zëvendësohen me lidhjet 1/a, 1/b, 2 dhe 4, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

III. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe njësitë e qeverisjeve vendore për pyjet dhe kullotat komunale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

SHTOJCA
PËR TARIFAT NË SEKTORIN F PYJEVE DHE TË KULLOTAVE
TARIFAT BAZË TË LËNDËS DRUSORE NË KËMBË

Lidhja 1/a

Nr. rendor	Emërtimi	Njësi matje	Tarifa (lekë)	
			E hollë deri 22 cm	E mesme dhe e trashë mbi 22 cm
	I. Lëndë punimi në këmbë			
	a) Halorë			
1	Pishë e zezë	m^3	2 500	3 500
2	Pishë mesdhetare (pishë e butë, pishë e egër, pishë deti)	m^3	2 300	3 200
3	Bredh	m^3	2 700	3 800
	b) Fletorë			
1	Ah	m^3	1 700	3 100
2	Dushk	m^3	2 300	4 000
	II. Dru zjarri			
	a) Të forta			
1	Dushk, ah, panjë, frashër, rrap, akacie, lofatë, gështenjë, mare, shkozë, mëllezë, bli, lajthi, thanë, mrete, bush.	m^3	500	
	b) Të buta	m^3		
1	Halorë, shelg, plep dhe vërri			
			200	

TARIFË BAZË TË LËNDËS DRUSORE NË KËMBË, PËR LLOJET INDUSTRIALE

Lidhja I/b

Nr. rendor	Emërtimi	Njësia e matjes	Tarifa (lekë)
	Lëndë druri në këmbë		
1	Arrë, gështenjë, panjë, vidh	m^3	6 700
2	Carac, eukalipt, man, mëllezë, plep, rrap, shelg, shkozë	m^3	2 600
3	Bli, frashër, gështenjë e egër, mështekën, vërri	m^3	5 000

Shënime

1. Tarifat e përcaktuara në lidhjet l/a dhe l/b shërbejnë si bazë për të përllogaritur koston e prodhimit për lëndën drusore të asortuar që trajtohet në pikën 1 të vendimit.

2. Kur lënda e punimit dhe drutë e zjarrit janë nxjerrë nga sipërfaqe të djegura, por materiali drusor është i përdorshëm, tarifat për to do të jenë 40% më e të ulëta se tarifat bazë.

LIDHJA NR.2
TARIFAT DYSHEME PËR DHËNIEN NË PËRDORIM ME KONTRATË QIRAJE TË FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE

1. Ngritje fidanishte pyjore, bazë didaktike dhe eksperimentale kërkimore-shkencore në fushën e pyjeve dhe kullotave				
Nr.	Përdorimi i territorit	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit		
		1 vit	2-5 vjet	6-10 vjet
1	Pyll, trungishte	4 500	4 250	4 000
2	Pyll, cungishte	3 600	3 400	3 000
3	Pyll, shkurre	3 600	3 400	3 000
4	Kullotë	3 600	3 400	3 000
5	Tokë me bimësi pyjore, djerr	2 700	2 600	2 000

2. Për mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme				
Nr.	Përdorimi i territorit	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit		
		1 vit	2-5 vjet	6-10 vjet
1	Pyll, trungishte	24 000	23 000	20 000
2	Pyll, cungishte	21 600	20 700	18 000
3	Pyll, shkurre	21 600	20 700	18 000
4	Tokë me bimësi pyjore, djerr inproduktive	18 000	17 250	12 000

3. Për mbarështimin e faunës së egër dhe gjahut				
Nr.	**Përdorimi i territorit**	**Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit**		
		1 vit	**2-5 vjet**	**6-10 vjet**
1	Pyll, trungishte	36 000	34 000	30 000
2	Pyll, cungishte	24 000	23 000	20 000
3	Pyll, shkurre	24 000	23 000	20 000
4	Kullota	24 000	23 000	20 000
5	Tokë me bimësi pyjore, djerr	18 000	17 000	15 000
6	Inproduktive	18 000	17 000	15 000

4. Agropylltari				
Nr.	**Përdorimi i territorit**	**Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit**		
		1 vit	**2-5 vjet**	**6-10 vjet**
1	Tokë me bimësi pyjore, djerr	15 000	13 000	10 000

5. Për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore, shoqërore dhe për veprimtari turistike kampingje (kënde lodrash, mjedise sportive, shlodhëse etj.)				
Nr.	**Përdorimi i territorit**	**Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit**		
		1 vit	**2-5 vjet**	**6-10 vjet**
1	Pyll trungishte	180 000	120 750	100 000
2	Pyll cungishte	126 000	90 000	75 000
3	Pyll shkurre	126 000	90 000	75 000
4	Kullota	126 000	90 000	75 000
5	Tokë me bimësi pyjore, djerr	90 000	52 000	45 000
6	Inproduktive	90 000	52 000	45 000

6. Për nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte, direkt nga sipërfaqja (karrierë)				
Nr.	**Përdorimi i territorit**	**Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit**		
		1 vit	**2-5 vjet**	**6-10 vjet**
1	Inproduktive	540 000	495 000	440 000

7. Për vendosje antene të telefonisë fikse, të lëvizëshme, televizive, radio-komunikimit			
Nr.	**Përdorimi i territorit**	**Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit**	
		1-5 vjet	**6-10 vjet**
1	Pyll trungishte	11 250 000	10 000 000
2	Pyll cungishte	8 500 000	8 000 000
3	Pyll shkurre	8 500 000	8 000 000
4	Kullota	8 500 000	8 000 000
5	Tokë me bimësi pyjore, djerr	6 500 000	5 500 000
6	Inproduktive	5 500 000	5 000 000

8. Për ndërtim teleferik pasagjerësh ose linje të tensionit, aerogjeneratorë (stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse etj.).				
Nr.	**Përdorimi i territorit**	**Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit**		
		1 vit	**2-5 vjet**	**6-10 vjet**
1	Pyll trungishte	240 000	230 000	210 000
2	Pyll cungishte	192 000	184 000	176 000
3	Pyll shkurre	192 000	184 000	176 000
4	Kullota	192 000	184 000	176 000
5	Tokë me bimësi pyjore, djerr	156 000	150 000	143 000
6	Inproduktive	156 000	150 000	143 000

9. Për kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit hidrokarbure, gjeologjike e minerare, uji, vendosje objektesh të ndryshme ndihmëse në sipërfaqe			
Nr.	**Përdorimi i territorit**	**Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit**	
		1-5vjet	**6-10 vjet**
1	Pyll trungishte	120 000	96 000
2	Pyll cungishte	96 000	78 000
3	Pyll shkurre	96 000	78 000
4	Kullota	96 000	78 000
5	Tokë me bimësi pyjore, djerr	76 800	62 000
6	Inproduktive	76 800	62 000

10. Për ndërtime objekte bare restorante, karburante			
Nr.	**Përdorimi i territorit**	**Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit**	
		1-5vjet	**6-10 vjet**
1	Pyll trungishte	7 500 000	7 125 000
2	Pyll cungishte	7 125 000	5 000 000
3	Pyll shkurre	7 125 000	5 000 000
4	Kullota	7 125 000	5 000 000
5	Tokë me bimësi pyjore, djerr	5 000 000	4 000 000
6	Inproduktive	5 000 000	4 000 000

11. Për shtrirje tubacionesh dhe linjash në sipërfaqe, si dhe ndërtim kanalesh (uji, naftë, gazi, tensioni elektrik etj.)				
Nr.	**Përdorimi i territorit**	**Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/km/vit**		
		1 vit	**2-5 vjet**	**6-10 vjet**
1	Pyll trungishte	240 000	220 000	175 000
2	Pyll cungishte	190 000	176 000	145 000
3	Pyll shkurre	190 000	176 000	145 000
4	Kullota	190 000	176 000	145 000
5	Tokë me bimësi pyjore, djerr	160 000	145 000	110 000
6	Inproduktive	150 000	145 000	110 000

12. Për ndërtim/përdorim rruge për lidhjen e sipërfaqes së dhënë në përdorim, me rrjetin rrugor ekzistues		
Nr.	**Përdorimi i territorit**	**Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës për sipërfaqen e marrë në përdorim lek/km/vit**
1	Pyll trungishte	70 000
2	Pyll cungishte	50 000
3	Pyll shkurre	35 000
4	Kullota	35 000
5	Tokë me bimësi pyjore, djerr	30 000
6	Inproduktive	25 000

13. Për ndërtim rezervuarësh për zhvillimin e akuakulturës			
Nr.	**Përdorimi i territorit**	**Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit**	
		1-5vjet	**6-10 vjet**
1	Pyll trungishte	360 000	270 000
2	Pyll cungishte	270 000	180 000
3	Pyll shkurre	270 000	180 000
4	Kullota	270 000	180 000
5	Tokë me bimësi pyjore, djerr	180 000	126 000
6	Inproduktive	180 000	126 000

14.Vendosje kaminash për prodhim qymyr druri dhe eshkës së kovaçit, furrë gëlqereje, sheshe për depozitimin e përkohshëm të materialeve të ndryshme (pika transiti) etj.

Nr.	**Përdorimi i territorit**	**Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit**
1	Tokë me bimësi pyjore, djerr	250 000
2	Inproduktive	100 000

15.Ndërtim linje të tensionit të lartë

Nr.	**Përdorimi i territorit**	**Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës km/vit**
1	Pyll trungishte	60 000
2	Pyll cungishte	35 000
3	Pyll shkurre	25 000

LIDHJA 4

Tarifat për pjesë të fondit pyjor dhe kullosor publik, që hiqen si pasojë e ushtrimit të veprimtarive të parashikuara sipas nenit 7 të ligjit nr.9791, datë 23.7.2007 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” dhe në nenin 10 të ligjit nr.9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullosor”, të ndryshuar, përllogariten duke mbajtur parasysh:

a) investimet e kryera për pyllëzimin (ripyllëzimin), përmirësimin e kullotës, si dhe investimet e kryera gjatë periudhës së rritjes, për sipërfaqen që hiqet nga fondi pyjor dhe kullosor kombëtar;

b) të gjitha shpenzimet e tjera për mbrojtjen e tokës, për shfrytëzim të qëndrueshëm dhe produktiv;

c) shpenzimet për ndërtimin e infrastrukturës përkatëse;

d) vlerën e burimeve pyjore e jopyjore bashkëshoqëruese (lënda drusore, flora spontane, fauna e egër, kullota, etj.), si produkt i humbur;

e) investimet që do të kryhen për pyllëzimin (ripyllëzimin), përmirësimin e kullotës, për sipërfaqen që do të zëvendësojë sipërfaqen e hequr nga fondi pyjor dhe kullosor kombëtar.

VENDIM
Nr.1065, datë 29.12.2010

PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E KRYERJES SË RIMBURSIMIT NGA TAKSA E BIZNESIT TË VOGËL TË PAGESËS PËR PAJISJET FISKALE DHE TAKSIMETRAT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Bizneseve, objekt i ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, që kanë bërë pagesën e blerjes së pajisjes së parë fiskale deri në datën 28.2.2011, nga "Shoqëritë e autorizuara", sipas kontratës përkatëse, u rimbursohet kjo pagesë deri në shumën 44 000 (dyzet e katër mijë) lekë, pa TVSH.

2. Tatimpaguesi duhet të dorëzojë pranë zyrës së taksave të bashkisë apo të komunës, ku është i regjistruar, brenda datës 31 mars 2011, formularin e rimbursimit të pagesës për pajisjen fiskale sipas formatit bashkëlidhur këtij vendimi, së bashku me dokumentacionin, si më poshtë vijon:

a) Kopjen e mandatpagesës së bërë për blerjen e pajisjes së parë fiskale ose kuponin tatimor, të shoqëruara me kopjen e faturës së blerjes;

b) Kopjen e kontratës me një nga "Shoqëritë e autorizuara" nga Ministri i Financave për ofrimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve fiskale në rastin e pajisjeve fiskale, ose shoqërinë shitëse, në rastin e taksimetrave;

c) Kopjen e njoftim-vlerësimit tatimor për vitin ushtrimor 2010, të lëshuar nga zyra e taksave të bashkisë ose të komunës.

ç) Deklaratën e vendosjes në punë të pajisjes fiskale.

3. Zyrat e taksave të bashkive ose të komunës, ku është i regjistruar tatimpaguesi, bëjnë përllogaritjen e detyrimit të kësteve të taksës së biznesit të vogël, sipas nenit 11 të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006. Në rast se plotësohen kushtet e përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, rimbursimi fillon me kështin e tremujorit të katërt të vitit 2010, i cili paguhet deri në datën 20 janar 2011, dhe në rast se:

a) diferenca ndërmjet kështit për t'u paguar dhe shumës së rimbursueshme është pozitive, tatimpaguesi paguan këtë diferencë;

b) diferenca ndërmjet kështit për t'u paguar dhe shumës së rimbursueshme është negative, mbartet për t'u rimbursuar nga kështet pasardhëse.

4. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga afati i pagesës së kështit pasardhës të taksës së biznesit të vogël, drejtoritë rajonale të taksave, në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, rakordojnë me zyrat e taksave të bashkive dhe të komunave për shumat e pagesave të pajisjeve fiskale të biznesit të vogël për t'u rimbursuar nëpërmjet taksës së biznesit të vogël.

5. Bizneseve, subjekt i biznesit të vogël, që janë të përfshira në skemën e TVSH-së apo që do të përfshihen në skemën e TVSH-së brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e ligjit nr.10 354, datë 18.11.2010 "Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, TVSH-ja e paguar për blerjen e pajisjes fiskale u kreditohet sipas procedurave të përcaktuara në ligjin për TVSH-në.

Bizneseve të tjera, që nuk janë të përfshira në skemën e TVSH-së dhe që nuk regjistrohen në skemën e TVSH-së brenda 6 (gjashtë) muajve, TVSH-ja e paguar për blerjen e pajisjes fiskale do t'u rimbursohet nëpërmjet reduktimit të kësteve të taksës së biznesit të vogël.

6. Bizneseve, subjekt i biznesit të vogël, që operojnë në fushën e transportit sipas përcaktimeve të bëra në aneksin 5 të ligjit për taksat vendore dhe që kanë detyrimin për t'u pajisur me taksimetër, u rimbursohet pagesa e bërë për blerjen e taksimetrit, sipas faturës përkatëse, deri në shumën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë, pa TVSH.

Dokumentacioni dhe procedura e këtij rimbursimi është e njëjtë si në rastin e rimbursimit për pajisjet fiskale, të përcaktuar në këtë vendim.

7. Ngarkohen Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Ministria e Brendshme dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Formulari[1] i Rimbursimit të Pagesës për Pajisjen Fiskale

1. Te dhenat e subjektit:

Emri i Subjekti	_____
NIPT	_____
Adresa	_____
Telefon	_____
E-mail	_____
Bashkia/Komuna[2]	_____

2. Te dhenat per pajisjen fiskale qe do te rimbursohet:

Emri I shoqerise[3]	_____	
Vendi I Blerjes[4]	_____	
Te dhenat e fatures[5]	_____	
Tipi I pajisjes	_____	
Nr. Serial I pajisjes	_____	
Cmimi i blerjes pa TVSH[6]	_____	LEKE
TVSH	_____	LEKE

3. Llogaritja e rimbursimit te pajisjes fiskale:

Kestet e takses vendore sipas njoftim-vlersimit

Viti 2010	Kesti I	Kesti II	Kesti III	Kesti IV
	✖	✖	✖	
Viti 2011	Kesti I	Kesti II	Kesti III	Kesti IV

1. Shuma e **kestit IV** per vitin 2010 ne Leke	1	
2. Çmimi I blerjes pa TVSH por jo me I madh se 44,000 Leke pa TVSh	2	
3. Kesti i ngelur per tu paguar 3 = 1 - 2	3	
Nese rezultati kutisë 3 eshte negativ rimbursimi vazhdon me kestet pasardhes		
1. Shuma e **kestit I** per vitin 2011 ne Leke	1	
2. Vlera e mbetur per tu rimbursuar	2	
3. Kesti I ngelur per tu paguar 3 = 1 - 2	3	
Nese rezultati kutisë 3 eshte negativ rimbursimi vazhdon me kestet pasardhes		
1. Shuma e **kestit II** per vitin 2011 ne Leke	1	
2. Vlera e mbetur per tu rimbursuar	2	
3. Kesti i ngelur per tu paguar 3 = 1 - 2	3	
Nese rezultati kutisë 3 eshte negativ rimbursimi vazhdon me kestet pasardhes		
1. Shuma e **kestit III** per vitin 2011 ne Leke	1	
2. Vlera e mbetur per tu rimbursuar	2	
3. Kesti i ngelur per tu paguar 3 = 1 - 2	3	
Nese rezultati kutisë 3 eshte negativ rimbursimi vazhdon me kestet pasardhes		
1. Shuma e **kestit IV** per vitin 2011 ne Leke	1	
2. Vlera e mbetur per tu rimbursuar	2	
3. Kesti I ngelur per tu paguar 3 = 1 - 2	3	

*Nese rimbursimi nuk eshte realizuar plotesisht gjate periudhes tatimore 2010 - 2011 vazhdohet ne te njejten menyre llogaritje per vitin 2012.

Ky formular plotesohet nga tatimpaguesi dhe aprovohet nga inspektoret e zyres se taksave vendore
Formulari I nenshkruar nga tatimpaguesi dhe inspektori tatimor administrohet nga zyrat e taksave vendore
Nje fotokopje te ketij formulari te vulosur nga zyra e taksave te pushtetit vendor tatimpaguesi e dorezon prane prane tatimor se bashku me dokumentacionin e llogaritjes se te ardhurat vjetore nga aktiviteti I bisnesit

Tatimpaguesi	Inspektori
Emer Mbiemer Firme	Emer Mbiemer Firme
(_____)	(_____)

1.Plotesimi I formularit te rimbursimit te pajisjeve fiskale oranohet vetem nga subjektet e Bisnesit te Vogel

2. Ne kete kolone shkruhet zyra e taksave te bashkise apo komunes ne te cilen subjekti paguan taksen vendore

3. Emri I shoqerise se autorizuar ne te cilen eshte blere pajisja fiskale

4. Te shkruhet adresa e shoqerise se autorizuar ne te cilen eshte blere pajisja fiskale (Qyteti/Bashkia/Komuna)

5. Te shkruhen te dhenat identifikuese te fatures se blerjes (Nr. Serial, Data)

6. Cmimi I blerjes se pajisjes fiskale pa TVSH te shorehur ne LEKE

7. Vlera e rimbursueshme eshte cmimi I blerjes se pajisjes fiskale pa TVSH por jo me I madhe se 44.000 Leke

Ne rast se cmimi I blerjes pa TVSH eshte, me I vogel se 44.000 Leke Vlera e rimbursimit do te jete cmimi faktik i blerjes pa TVSH

VENDIM
Nr.1066, datë 29.12.2010

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILAT PREKEN NGA RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS "GJOKAJ", NË BASHKINË E VORËS TË QARKUT TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5/1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rikonstruksioni i rrugës "Gjokaj", në bashkinë e Vorës, të qarkut të Tiranës.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Vorës.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse, pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për sipërfaqet, 103 (njëqind e tre) m^2, truall dhe 86 (tetëdhjetë e gjashtë) m^2, objekt, në masën e përgjithshme të shpronësimit, 1 946 401 (një milion e nëntëqind e dyzet e gjashtë mijë e katërqind e një) lekë.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit të përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Vorës planifikuar në buxhetin e saj.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet po nga bashkia e Vorës.
6. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
7. Afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga bashkia e Vorës, për realizimin e këtij projekti.
8. Regjistrimi i ri i pasurive, 103 (njëqind e tre) m^2, truall dhe 86 (tetëdhjetë e gjashtë) m^2, objekt, shpronësuar në favor të bashkisë së Vorës, të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
9. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Vorës për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PRONARËVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR "RIKONSTRUKSIONIN E RRUGËS GJOKAJ", NË BASHKINË E VORËS, QARKU TIRANË

Nr.	**Emër, mbiemër**	**Sip. m^2 truall**	**Çmimi lekë/m^2**	**Vlera në lekë**	**Zona kadastrale**	**Nr. i pasurisë**
1	Jahe Liman Sipri	103	1258	129574	1751	3365/3/1
Nr.	**Emër mbiemër**	**Sip. m^2 objekt**	**Çmimi lekë/m^2**	**Vlera në lekë**	**Zona kadastrale**	**Nr. i pasurisë**
1	Jahe Liman Sipri	86	21 125.9	1 816 827	1751	3365/3/1
	Totali lekë			**1 946 401**		

VENDIM
Nr.1067, datë 29.12.2010

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILAT PREKEN NGA SISTEMIM - ASFALTIMI I BLLOKUT LINDOR, LAGJJA E STANIT NË BASHKINË E DIVJAKËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5/1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga sistemim - asfaltimi i bllokut lindor, Lagjja e Stanit, në bashkinë e Divjakës.

2. Shpronësimi bëhet në favor të bashkisë së Divjakës.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse, pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për sipërfaqen 323 (treqind e njëzet e tre) m^2, tokë truall, pronë private, në masën e përgjithshme të shpronësimit, 807 500 (tetëqind e shtatë mijë e pesëqind) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit të përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Divjakës, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet po nga bashkia e Divjakës.

6. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga bashkia e Divjakës, për realizimin e këtij projekti.

8. Regjistrimi i ri i pasurisë, 323 (treqind e njëzet e tre) m^2, tokë truall, shpronësuar në favor të bashkisë së Divjakës, të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

9. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi "Proces regjistrimi", të kompensohen, për efekt shpronësimi, me përfundimin e procesit të regjistrimit dhe pasi të kenë dorëzuar dokumentacionin e pronësisë, pranë bashkisë së Divjakës. Deri në këtë çast, paratë të qëndrojnë të bllokuara në bankë.

10. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Divjakës për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR "SISTEMIM-ASFALTIMIN E BLLOKUT LINDOR, LAGJA E STANIT", NË BASHKINË E DIVJAKËS

Nr.	Emër, mbiemër	Sip. truall m^2	Çmimi lekë/m^2	Vlera në lekë	Nr. i pasurisë	Zona kadastrale	Dokumentet e pronësisë
1	Panajot Tashi	90	2500	225 000	452/21	1492	Proces
2	Thoma Biti	233	2500	582 500	437/59	1492	Proces
	Totali	**323**		**807 500**			

VENDIM
Nr.1068, datë 29.12.2010

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË IEVP BURGU NR.325, BURGU VAQAR, BURGU NR.302, SPITALI I BURGUT TIRANË, IEVP SHËNKOLL, LEZHË, IEVP BËNÇË, TEPELENË, IEVP RROGOZHINË, IEVP LUSHNJË (FSHATI KOSOVË, KOMUNA FIERZË, ELBASAN) DHE TË GODINËS SË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BURGJEVE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË DREJTËSISË, PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BURGJEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të IEVP burgu nr.325, Burgu Vaqar, Burgu nr.302, Spitali i Burgut Tiranë, IEVP Shënkoll, Lezhë, IEVP Bënçë, Tepelenë, IEVP Rrogozhinë, IEVP Lushnjë (fshati Kosovë, komuna Fierzë, Elbasan) dhe të godinës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Drejtësisë, për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.

Lista me 22 (njëzet e dy) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, ka 9 (nëntë) prona.

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Drejtësisë dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1069, datë 29.12.2010

PËR MIRATIMIN E DËMSHPËRBLIMIT FINANCIAR PËR ISH-TË DËNUARIT POLITIKË TË REGJIMIT KOMUNIST

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9 e 10 të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 "Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e dëmshpërblimit financiar për ish-të dënuarit politikë dhe për familjarët e të dënuarve, me dënim kapital, sipas listës së përfshirë në anekset "A", "B" dhe "C", që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Masa e dëmshpërblimit për ish-të dënuarit politikë dhe familjarët e të dënuarve me dënim kapital, të bëhet me këste, sipas kritereve e kufijve të përcaktuar në nenin 12 të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 "Për dëmshpërblimin e ish–të dënuarve politikë të regjimit komunist", të ndryshuar.

3. Shuma e llogaritur transferohet në një llogari speciale në Bankën e Shqipërisë. Pagesa e dëmshpërblimit për secilin përfitues bëhet nga Ministria e Financave, në llogaritë personale të këtyre përfituesve, të hapura në bankat e nivelit të dytë, të përzgjedhura, sipas nenit 33 të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007, të ndryshuar.

4. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TABELA A

LISTA NR.11 E ISH-TË DËNUARVE TË CILËT KANË VUAJTUR DËNIM ME BURG

Nr.	Nr. Dosjes	Data e dosjes individuale	Emër	Mbiemër	Atësi	Amësi	Datëlindja	Vendlindja	Gjinia	Periudha e plotë e vuajtjes së dënimit	Shuma e dëmshpërblimit në lekë	Përfitimet nga ligje të mëparshme				Dëmshpërblimi përfundimtar
												Ministria e Financës		Enti Kombëtar i Banesave	Z.Q.R.P.P	
												Lekë	Letra me Vlerë			
1	191	05.02.2008	Adem	Allçi	Isuf	Zyftije	06.03.1942	Tropojë	M	26 vjet 11 muaj 1 ditë	14,840,000	200,000	0	1,543,636	0	13,096,364
2	256	06.02.2008	Daut	Kurtulaj (Keqi)	Sokol	Xhike	18.03.1895	Shkodër	M	3 vjet 10 muaj 20 ditë	2,850,000	131,600	388,260	0	0	2,330,140
3	1141	19.02.2008	Rrok	Gjinaj	Ndoc	Lobe	17.08.1936	Shkodër	M	2 vjet 10muaj 9ditë	2,098,000	120,000	480,000	0	0	1,498,000
4	1146	19.02.2008	Demir	Mahmuti	Lalush	Salushe	16.12.1904	Berat	M	4 vjet 10 muaj	2,950,000	200,000	480,932	0	0	2,269,068
5	1551	22.02.2008	Thoma	Shano	Spiro	Janulla	28.02.1930	Çukë, Sarandë	M	12 vjet, 5 muaj, 17 ditë	9,104,000	200,000	1,294,284	0	0	7609716
6	2227	03.03.2008	Sytki	Jera	Sulejman	Zenepe	30.09.1944	Shkodër	M	D1. 11 muaj 14 ditë D2.7 vjet 1 muaj 13 ditë	5,556,000	0	886,000	0	0	4670000
7	2314	03.03.2008	Prelë	Lumaj	Kolë	Terezë	26.08.1918	Shkoder	M	5vjet 1muaj 9ditë	3,730,000	100,000	612,252	0	0	3017748
8	2621	05.03.2008	Mustafa	Canaj	Murat	Aishe	20.09.1933	Çamëri	M	4 vjet	2,920,000	100,000	370,000	0	0	2,450,000
9	2641	05.03.2008	Adem	Xhangolli	Hasan	Bajame	20.04.1934	Korçë	M	6 vjet, 7 muaj, 21 ditë	4,856,000	100,000	800,000	0	0	3,956,000
10	2787	06.03.2008	Shaho	Çelaj	Selfo	Velide	16.09.1885	Tepelenë	M	2vjet 6muaj 9ditë	1,850,000	400,000	203,452	0	0	1,246,548
11	2959	07.03.2008	Hysen	Kullolli	Abdulla	Nafije	17.07.1953	Shkoder	M	6muaj 15ditë	402,000	0	0	0	0	402,000
12	2993	07.03.2008	Fejzulla	Koçi	Isuf	Dile	01.11.1914	Gramsh	M	5 vjet 3 muaj	3,836,000	0	600,000	800,000	0	2,436,000
13	3113	10.03.2008	Neki	Pirra	Azis	Fatime	15.05.1940	Pirre, Lushnje	M	7 vjet 7 muaj 7 ditë	2,668,000	0	640,458	0	0	2027542
